



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 19, 24, 26 qershor 2019 dhe 4 korrik 2019.
2. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike lidhur me gjendjen në shërbimin civil për vitin 2018”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Edmond Leka Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Spartak Braho, Aurora Mara, Damian Gjikhuri, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Ftohen mediet të jenë në sallë.

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të komisionit. Shumica e anëtarëve të komisionit janë të pranishëm për të filluar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Fillimisht kemi miratimin e procesverbaleve të datave 19, 24, 26 qershor dhe 4 korrik të vitit 2019, të cilat ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike.

Ka vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të komisionit? Nuk ka vërejtje.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të datave 19.06.2019, 24.06.2019, 26.06.2019 dhe 04.07.2019.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit nën për nën të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””. Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore do të jetë kolegja Vasilika Hysi.

Gjithashtu, prezente nga stafi i Kuvendit kemi zonjën Pano, drejtoreshën e Shërbimit të Seancave Plenare.

Zonja Hysi, kemi lënë të pambyllura pak nene në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, të cilat do t’i kalojmë dhe pastaj do t’i miratojmë në tërësi.

Po, zoti Alimadhi, për procedurë.

Adriatik Alimadhi – Në fakt, ky projektvendim i rëndësishëm ka nisur me ish-deputetët e opozitës. Personalisht, do të kërkoja, në qoftë se deputetët e opozitës kanë bërë propozime gjatë asaj kohe dhe do të ishte e mira që edhe ne si deputetë të njiheshim, në fakt, me të gjitha propozimet që kanë bërë ata.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Projekti i ndryshimeve në Rregullore është produkt i një pune dyvjeçare të bërë nga deputetët, nga grupet parlamentare, nga stafi i Kuvendit, nga drejtoritë, të cilat janë një sërë rekomandimesh të institucioneve ndërkombëtare lidhur me transparencën e Kuvendit.

Të nderuar kolegë, produkti që ju keni pasur në fillim, sapo morët mandatin, ishte i dakordësuar me disa ndryshime të nevojshme për diskutim, siç ka çdo deputet të drejtë të diskutojë, të bëjë amendamente e të tjera.

Besoj se shërbimet e Kuvendit ia kanë dërguar më shumë se një herë çdo deputeti projektin, pavarësisht se deputeti ose deputetja është anëtare e Komisionit të Ligjeve, me qëllim që të merren opinione, amendamente, të ketë pyetje.

Gjithashtu, kryetarët e grupeve parlamentare e kanë marrë zyrtarisht kopjen e tij dhe është ndër të vetmit projektligje, i cili ka pasur këtë shtrirje, sepse në përgjithësi çdo komision përgjegjës, edhe ato për dhënie mendimi, e marrin detyrimisht draftin, ndërkohë që për të tjerët varet nga dëshira e deputetëve nëse duan ta studiojnë ose jo.

Ndërkohë, diskutimi në komision ka filluar që në muajin dhjetor. Pra, kemi gjashtë muaj e gjysmë që e diskutojmë këtë Rregullore në parim dhe nen për nen.

Njëkohësisht, si anëtarë të komisionit, secili prej deputetëve gjatë diskutimit nen për nen ka të drejtë të bëjë përmirësime dhe ndryshime.

Të nderuar kolegë, edhe personalisht, që jam relatore, nuk kam guxuar të ndërhyj në nene në momentin kur diskutohet, sepse është Rregullore, është pothuajse ligj që kërkon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është me 71, por ne kemi pranuar ta kalojmë gjithnjë bashkë me opozitën. Por, nisur nga fakti se ne nuk e kishim në parlament opozitën, e cila ka dalë në rrugë, e bllokua punën, megjithëse i kishim votat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse kërkonim të jetë një Rregullore që do të ketë konsensusin e të gjithëve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Shikoni, ne jemi deputetë të rinj, kjo është e vërtetë, por unë nuk e shoh të arsyeshme që, kur kalojnë norma juridike shumë të dobishme, ne të flasim me ngarkesat që kemi punuar si relatorë dhe t'i detyrojmë deputetët të vazhdojnë me paraqitjen e relatorit ose të relatores në këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ju nuk na i sillni propozimet e ish-deputetëve të opozitës, mendoj që e përshpejtoni vendimin për ndryshimin e Rregullores.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Unë kërkoj që të vijnë materialet dhe mbledhja të shtyhet për një kohë tjetër.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Le ta keni. Unë kam mendimin tim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Mos harroni që keni ndërhyrë në shumë pika të neneve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo bashkërisht, por ne nuk na keni dëgjuar fare.

Bashkim Fino – Kush tha?!

Adriatik Alimadhi – Ky është një nga vendimet e mia pse votoj kundër.

Në qoftë se ju...

Bashkim Fino – Kjo është çështja juaj.

Adriatik Alimadhi – Mirë, edhe kjo është çështja jote pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Me leje?

Ulsi Manja – Po, zoti Fino, për procedurë.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, për procedurë, ajo që tha zonja Hysi është e vërtetë. Kjo projektregullore po studiohet prej dy vjetësh dhe u është shpërndarë të gjithë deputetëve për të dhënë mendime, ku edhe unë kam qenë dhe kam dhënë mendimet personale.

Një pjesë e mirë e propozimeve këtu janë të zotit Alibeaj, të cilat i përmenda edhe dje, pardje gjatë diskutimit, të cilat nuk i kemi ndryshuar, por i kemi lënë, sepse na intereson edhe neve që të jenë ashtu. Nuk kemi interes...

Për shembull, diskutimet për pyetje ministrash, për Kryeministrin, qoftë edhe që të hënave të bëhet seancë, ne i kemi vënë sipas propozimeve të PD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se deputetët e rinj kujtohen sot, që është dita e fundit, në të cilën po e mbyllim projektregulloren, dhe na thonë: “Na sillni këto!”, ne kemi bërë 5-6 seanca diskutimi për projektregulloren deri tani. Absolutisht, le t’ua japë zonja Pano të gjitha propozimet që kanë bërë edhe ata, edhe ne, por janë shumë propozime, të cilat grupi i punës dhe ky komision i ka definuar përfundimisht, duke ardhur në materialin që kemi sot. Pra, nuk mund ta fillojmë diskutimin nga e para sot që jemi në mbledhjen e fundit të diskutimit për Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndaj po e bëjmë sot mbledhjen dhe sakrifikuam që deputetët ta kenë mundësinë të bëjnë amendamente ose ndryshime të nevojshme deri të enjten tjetër. Ta marrin sot, siç ka ardhur materiali i shkruar komplet, që do ta kalojmë në tërësi, dhe le të bëjnë vërejtje për nenet që duan ose amendamentet e tyre dhe ne pastaj t'i diskutojmë në seancë plenare. Nuk mund ta shtyjmë mbledhjen pse kanë ardhur tani këta. Këta deputetë nuk quhen më të rinj! Kanë mbi gjashtë muaj që kanë ardhur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Materialet kanë qenë edhe këtu, edhe në kutinë postare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, nuk po them... Materialet kanë qenë këtu dhe ju i keni pasur, madje i kemi diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, ta mbyllë zoti Fino fjalën e tij...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ti thua sikur erdhe sot! Ti nuk erdhe sot, por ke kaq mbledhje që je këtu, që diskuton dhe që bëjmë debat bashkërisht. E kupton?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por nuk mund të thuash sot që është mbledhja e fundit: “Më jepni pak materialet, sepse sot dua t'i shoh unë!” Këtu i ke pasur të gjitha materialet dhe i ke!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Ju lutem!

Unë nuk e kuptoj çfarë problemi ka, zoti kryetar, që nuk na vihen në dispozicion propozimet e ish-deputetëve të Partisë Demokratike!

Ulsi Manja – Sepse është kohë e shkuar.

Adriatik Alimadhi – Ju lutem! Ato janë një orientim dhe një bazë ndoshta për ne për të parë edhe ndryshimet që kërkoni të bëni ju në Rregullore.

Unë nuk e di çfarë ju shtyn...

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Fino!

Ulsi Manja – I ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Jo, jo, unë dje gjatë debatit në një nen të përcaktuar në këtë projektvendim kuptova që ishte propozim i zotit Alibeaj. Ndaj, a ka mundësi që të na vijë propozimet e ish-deputetëve? E shtyjme mbledhjen e komisionit, se nuk u bë hataja!

Ore, sinqerisht, se jemi përpara opinionit publik: pse t'i bëjmë normat kaq të detyrueshme, kaq të shpejtuara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Nuk është e shpejtuar, kanë dy vjet ato!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Jo se dy vjet... Unë flas për pjesën time.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk votoj asnjë ligj, asnjë projektligj, asnjë projektvendim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, pra, e di! Sa shpejtoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos shpejtoni pra!

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Alimadhi, fokusojeni dhe përmbylleni mendimin tuaj, pasi duhet të vazhdojmë me rendin e ditës!

Adriatik Alimadhi – Çfarë ju shtyn të na jepni kohën...

Ulsi Manja – Jua jap unë përgjigjen!

Adriatik Alimadhi – Jo përgjigjen, por dua mundësinë...

Ulsi Manja – Patjetër edhe përgjigjen, edhe mundësinë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot do të miratojmë nenet e mbetura të Rregullores dhe këtë të fundit në tërësi për ta votuar në seancën plenare të ditës së enjte. Pse? Grupi i punës ka funksionuar prej dy vjetësh, ndërkohë që ju kërkoni propozimet e bëra nga ish-deputetët e opozitës, por unë jam në kohën e tashme dhe jo në të shkuarën.

Koha e tashme do të thotë opozita parlamentare është në sallë dhe deputetët e saj marrin pjesë në komisione. Një nga deputetët e opozitës jeni edhe ju dhe bashkë me kolegët keni pasur të gjithë mundësinë të studioni Rregulloren dhe të bëni propozimet konkrete, të bëni komente, por jo të merreni me të shkuarën.

Nuk duhet thënë ky është propozim i këtij, ky i atij. Zonja Hysi flitet për propozime të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë në Komisionin e Ligjeve, si komision i përhershëm. Ata që kishin ndër mend për të miratuar Rregulloren dhe për të bërë propozimet, të rrinin dhe të zbatonin kontratën që kishin me qytetarët. Tani unë kam për detyrë, sipas Rregullores, t'iu garantoj të drejtën deputetëve të opozitës dhe të maxhorancës të bëjnë propozime konkrete për Rregulloren. Nuk mund të merremi me të shkuarën.

Zonja Hysi, vazhdojmë me nenet e mbetura.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, nuk ka shtyrje! Ti mund të votosh si të duash, zoti Alimadhi, por nuk ka asnjë shtyrje.

Ju lutem, mos e zvarritni mbledhjen.

Adriatik Alimadhi – Nuk e di pse shpejtoni?

Ulsi Manja- Pse pak ju duken 2 vjet ju?

Adriatik Alimadhi – Nuk janë për ne. E keni gabim. Dje kam kuptuar se një propozim ishte i ish-deputetit, zotit Alibeaj. Po sikur të mos ishim ne këtu, çfarë do të bënit ju?

Ulsi Manja - Patjetër do t'i kalonim.

Adriatik Alimadhi - Për procedurë, unë kam propozuar të na vijnë të gjitha propozimet që kanë bërë ish-deputetët.

Vasilika Hysi – Merri në sekretari!

Adriatik Alimadhi - Mos të dukemi si studentë ne? Edhe dje komunikuat ndryshe. Nëse jeni e ngarkuar...

(Ndërrhyrje incizimi)

Ulsi Manja – Zonja Hysi, a mund të vazhdojmë me Rregulloren?

Adelina Rista- Ju lutem, zoti Alimadhi, kam fjalën për procedurë.

Zoti kryetar, ky projektligj në tryezat tona para çdo deputeti ka që në fillim të kësaj legjislature. Sa herë do të vijnë deputetë të rinj ne nuk do t'u kthehemi ligjeve për deputetët e rinj. Ka një shërbim parlamentar ku cilido deputet bën detyrën e vet, interesohet për të marrë materiale për projektligjet që ka para. Tashmë ne jemi në këtë fazë, ju lutem, edhe për procedurë po e them, kur ka një propozim, hidhet në votë, zoti kryetar! Dhe ne vazhdojmë, nuk ka pse të bëjmë zhurmë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Neni 11.

Adriatik Alimadhi - Për procedurë, zoti kryetar, dhe e hedhim në votim propozimin tim, që ta shtyjme që gjithë propozimet që kanë bërë ish-deputetët e opozitës të na vihen në dispozicion dhe mbledhja të shtyhet për një datë tjetër.

Ulsi Manja - Dakord.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alimadhi? Kundër? Abstenime?

Nuk miratohet.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Vasilika Hysi - Te neni 11 “Këshilli për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin” .

Ulsi Manja- Kjo u hodh në votim.

Valentina Hysi – Te neni 11, ndryshimet e bëra janë vetëm pjesët me ngjyrë më të errët, por, po të shikoni, në të gjithë projektligjin është futur neni i plotë për t’u lexuar i tërë, sepse nuk ndryshon e gjithë përmbajtja e ligjit.

Ulsi Manja- Zonja Hysi, ju lutem, fokusohuni këtu te Këshilli i Rregullores, i cili është organ këshillimor i Kuvendit. Pra, vazhdon të ruajë atë status, por ka marrë edhe disa kompetenca lidhur me Kodin e Sjelljes.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 12.

Vasilika Hysi – Këshilli për Legjislacionin. Në këtë nen janë riformulimet e bëra.

Ulsi Manja – Atëherë, edhe në nenin 12 janë reflektuar të gjitha sugjerimet e kolegëve lidhur me Këshillin për Legjislacionin. Edhe ky është organ këshillimor i Kuvendit. Kush është pro me nenin 12? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 13.

Vasilika Hysi – Te neni 13 kanë gjetur reflektim sugjerimet e koleges Xhina.

Ulsi Manja- Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14.

Vasilika Hysi - Neni 14 është nen i ri, “Deklarimi i pozicionit politik të grupeve parlamentare”, ku rregullohet mënyra e deklarimit.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Ulsi Manja- Te cili nen do të kalojmë tani, zonja Hysi?

Vasilika Hysi– Do të kalojmë te neni 30. Dje zonja Bode ngriti një shqetësim, lidhur me pezullimin e seancave plenare dhe ne kishim bërë në një nen pezullimin e mbledhjeve të seancave dhe komisioneve. Pas shqetësimit që me të drejtë e ngriti zonja Bode , ne i ndamë këto dy nene, pra pezullimin e mbledhjeve të komisionit e lamë nen më vete, ndërsa pezullimin e seancave plenare, që është aktualisht në Rregulloren e Kuvendit e kemi lënë më vete. Do t'ju lutesha t'i shikoni, sepse është e njëjta gjë, por i kemi ndarë në dy nene.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te neni 67.

Vasilika Hysi – Neni 67 është “Heqja e imunitetit të deputetëve”. Në Rregulloren e Kuvendit vazhdon të jetë një gabim i madh sikur deputetët kanë imunitet në raport me ndjekjen penale. Në fakt, deputetët nuk kanë imunitet që nga viti 2012. Kjo Rregullore duhej të ishte ndryshuar, në fakt, kur u bë ndryshimi në vitin 2013 dhe në vitin 2016. Aktualisht është hequr ajo që thuhet se deputetët kanë imunitet për ndjekjen penale dhe prokuroria kërkon autorizim. Në këtë nen është lënë vetëm procedura si veprohet kur prokuroria kërkon autorizim për caktimin e masës së sigurimit të arrestit me burg ose shtëpi për heqjen e lirisë. Pra, në nenin 2 është rregulluar e drejta e deputetit që të paraqesë shpjegimet, vërejtjet, të ketë mbrojtës ligjor, të ketë të drejtë të bëjë pyetje, të mbrohet vetë ose me avokat. Kemi shkurtuar afatin e shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë, sepse ka qenë 4 javë, e kemi bërë 2 javë, gjithashtu, kemi kërkuar që Kuvendi të vendosë sipas Kushtetutës, nenit 73, pikat 3 dhe 4.

Pra, e kemi lënë thjesht procedurë dhe kemi hequr fjalët “deputeti ka imunitet ndaj ndjekjes penale”, sepse ne nuk kemi imunitet. Kjo është keqkuptuar dhe në të gjitha mediet thuhet sikur ne duam ta vëmë. Ne, në fakt, po e heqim imunitetin që është apo ka mbetur në Rregulloren aktuale nga Kushtetuta e mëparshme. Pra, po ta shikoni, në Rregullore thuhet: “Prokurori i Përgjithshëm” që tani nuk ekziston më.

Së dyti, thuhej: “Për të filluar ndjekjen penale, duhet të marrësh autorizimin në parlament”. Nuk është e vërtetë, ne ndiqemi penalisht pa autorizimin. Kjo gjë është që na nga viti 2012, por kishte ngelur e pandryshuar dhe nuk e di pse. Në këtë kuadër, kemi bërë referimin...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Në fakt, ka ndryshuar në vitin 2013, sepse kjo duhej të ishte ndryshuar që në vitin 2012.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Korab Lita – Neni “Për heqjen e imunitetit”, në këndvështrim me Kushtetutën, a është...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Lita!

Edhe një herë për transparencë, sepse ka pasur një dezinformim të publikut dhe sidomos nga media. Aktualisht, në Rregulloren e Kuvendit thuhet: “Kërkesa për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit”. Kjo është e shfuqizuar nga Kushtetuta, por e papasqyruar në Rregullore. Pikërisht këtë pikë ne e heqim, sepse ne si deputetë nuk kemi imunitet nga ndjekja penale. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne po pasqyrojmë Kushtetutën.

Në Kushtetutë thuhet: “Merret autorizim në Kuvend vetëm për masën e arrestit në burg, në shtëpi ose për heqjen e lirisë të çfarëdolloi forme tjetër, ose për kontrollin personal dhe të banesës”. Pikërisht vetëm për këtë është Rregullorja. Ndërkohë në Kushtetutë thuhet si voton Kuvendi: “Votimi është i hapur, ndërsa seancat mund të bëhen të mbyllura për të ruajtur të dhënat private”. Pra, ne kemi marrë këtë nen të Kushtetutës dhe e kemi vënë këtu. Po risia e këtij neni është që ne i japim të drejtë deputetit... Aktualisht e ka në çdo proces; në Këshillin e Mandateve deputeti mbrohet, përfaqësohet me avokat, përfaqësohet vetë, flet dhe dëgjohet.

Ulsi Manja - Urdhëroni, zoti Lita!

Korab Lita – Ju thatë se ka raste që seanca, mund të bëhet e mbyllur për të ruajtur...

Vasilika Hysi – E ka Kushtetuta.

Korab Lita – Po në rastet kur ka sekret shtetëror?

Vasilika Hysi - Kushtetuta, në nenin 73, pika 4, thotë: “Kuvendi merr vendim në seancë me dyer të mbyllura, kur kërkohet të ruhen të dhënat private ose këto që kanë të bëjnë me sekretin shtetëror”.

Ulsi Manja - Zonja Hysi, neni 73 i Kushtetutës është transfuzuar te nenet 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Pra, janë reflektuar ndryshimet e bëra në vitin 2016.

Vasilika Hysi – A dëshironi ta lexoj?

Ulsi Manja – Jo, nuk është nevoja, sepse është procedural.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, merak im është se në media, që edhe dje ka pasur njoftime të gabuara, ku thonë “Deputetët po heqin imunitetin”. Deputetët nuk kanë imunitet. Ne po heqim fjalinë e mbetur në Rregullore “që deputetët kanë imunitet”. Heqja e imunitetit do të thotë: “dhënia e autorizimit për arrest”.

Ulsi Manja – Që të jemi të qartë para se ta hedhim në votim: “Deputetët nuk kanë imunitet karshi ndjekjes penale dhe hetimit penal. Kuvendi jep autorizim vetëm në rastin e

arrestimit, të kontrollit personal dhe të kontrollit të banesës”. Vetëm këtë garanci ka dhënë neni 73 i Kushtetutës dhe i gjithë neni 68 është procedurë, pra si do të vepohet në rastet kur kërkohet arrestimi i deputetit, kontrolli personal dhe kontrolli i banesës. Ka kohë që deputeti nuk imunitet për sa i përket ndjekjes penale dhe hetimit penal.

Kush është dakord me nenin?

Urdhëroni!

Alket Hyseni – Nuk përputhet as titulli me Kushtetutën. Duke qenë se i kemi hequr imunitetin, nuk mund të quhet më “Heqja e imunitetit”, do ta quajmë “Dhënia e autorizimit për arrest dhe për kontroll”.

Ulsi Manja – Rregullojeni titullin e nenit 67 me terminologjinë, që përdor Kushtetuta, dhe është e zgjidhur çështja.

Kush është dakord me nenin 67? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 68. Është e njëjta logjikë.

Vasilika Hysi – I vetmi ndryshim është: në vend të emrit “Prokuror i Përgjithshëm” është shënuar “prokurori”, pasi “Prokuror i Përgjithshëm” nuk ka më kompetencë të kërkojë autorizim, në rast arresti në flagrancë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 68? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 69, që shton nenin 119/1 “Procedura e konstatimit të kufizimeve”.

Vasilika Hysi - Të nderuar kolegë, ne Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin herë pas here kemi pasur debate nëse vjen një kërkesë për papajtueshmëri nga ana e ndonjë deputeti ose për konflikt interesi, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mund ta shqyrtojë çështjen në substancë.

Përfundimisht, meqenëse është kompetente Gjykata Kushtetuese, ky nen synon të rregullojë pikërisht këtë gjë, pra që Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon vetëm plotësimin e kërkesave juridiko-formale, por nuk i hyn përmbajtjes, sepse gjithçka vlerësohet dhe është eskuzivitet i Gjykatës Kushtetuese.

Ulsi Manja – Në rregull.

Kush është dakord me nenin 69? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 69.

Zonja Hysi, a kemi nene të tjera për të hedhur në votim?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kemi nenin 73 “Aneksi për kufizimin e imunitetit dhe kushtet e autorizimit të ndjekjes penale”. Kjo shfuqizohet, sepse ne nuk kemi imunitet.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 73? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 74, dispozitë kalimtare. Nuk ka nevojë që Rregullorja si projektvendim të ketë...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ku do të reflektohen këto 3 nene?

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Unë kam propozime për disa nene.

Së pari, në nenin 7, paragrafi 3, togfjalëshi “përbërja e delegacioneve pasqyron për aq sa është mundur, përbërjen politike të Kuvendit deri në fund”, do të shfuqizohet. Pse?! Sepse, ne kemi delegacione të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare ose delegacione të përkohshme. Nuk kemi në Rregullore një parashikim të posaçëm për raportimin e këtyre delegacioneve, i cili, në fakt, kryhet nga kryesia e delegacioneve vetëm te Kryetari i Kuvendit për efekt të informimit të aktiviteteve që bëhen. Pjesëmarrja në organizata ndërkombëtare, për shembull, siç është Asambleja Parlamentare e NATO-s, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, OSBE-ja e shumë të tjera, janë jo vetëm mundësi për ne të marrim pjesë, por duke qenë se ne jemi edhe anëtarë në traktatet përkatëse të tyre, votojmë, marrim përsipër detyrime dhe kemi edhe të drejta. Në aktet, të cilat i votojmë në këto organizata, kur jemi në përbërje të delegacioneve të përhershme, marrim përsipër detyrime që duhet t’i zbatojmë në punën tonë në Kuvend. Për shembull, na duhet të reflektojmë edhe në ligje të cilat i miratojmë. Për shembull, siç ishte rasti para 2 ditëve, kur Avokatura e Shtetit raportoi këtu për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut. Ky ishte një detyrim, që rrjedh nga një rezolutë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës që ne e përfshimë. Pra, të gjithë deputetët edhe organet e Kuvendit, duhet të informohen për aktivitetin e delegacioneve të përhershme parlamentare. Prandaj kemi menduar të bëjmë një shtesë në Rregullore, një nen të ri, ku të parashikohet ky aktivitet i delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare, që normon pikërisht pjesën e Raportimit. Të njëjtat rregulla do të aplikohen edhe për delegacionet e përkohshme. Siç e keni përpara propozimin, një rol ka edhe Sekretariati i Marrëdhënieve me Jashtë, që koordinon të gjithë pjesën e informacionit. Ky është nen, të cilin unë mendoj ta shtojmë...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo, Sekretariati nuk bën raportim që t’jua shpjegojmë.

Ulsi Manja – Zoti Fino delegacionet e përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare të bëjnë një raport (pasi vijnë prej jashtë) dhe ta dorëzojnë këtu.

Klotilda Bushka – Delegacioni, që përbëhet nga deputetë, nuk harton raport fizikisht, por është departamenti përkatës i marrëdhënieve me jashtë, që harton raportin nën mbikëqyrjen e anëtarëve të atij delegacioni. Sekretariati i Marrëdhënieve me Jashtë, që përbëhet nga deputetë, duhet ta marrë këtë raport dhe, nëpërmjet masave që duhen marrë, të vërë në zbatim gjithçka që thuhet në të. Unë mendoj që për këtë nen, ose duhet të bëjmë një kapitull të ri dhe të themi “marrëdhëniet me jashtë”, ose ta shtojmë direkt pas nenit 7/1.

Vasilika Hysi – Unë dua ta falënderoj shumë zonjën Bushka për këtë sugjerim, i cili është shumë i vlefshëm, pasi ne kemi shumë pak deputetë që përfshihen në delegacionet e përhershme dhe të përkohshme, por çdo deputet ka të drejtë të njihet se me atë se çfarë ndodh dhe të orientohet në punën e tij! Edhe amendamenti i zonjës Bushka është shumë i qartë, por lidhur me vendin se ku mund të jetë nuk mund të futet te parimet e përgjithshme, sepse te kreu I janë organet e Kuvendit dhe mund t’ia lëmë si detyrë Mozës për ta renditur, por e rëndësishme është ta miratojmë.

Lidhur me përmbajtjen, unë mendoj se është shumë mirë dhe më mirë nuk bëhet.

Ulsi Manja- Kush është dakord me shtimin e një neni të ri me këtë titull: “Delegacionet e përhershme të Kuvendit pranë organizmave ndërkombëtare”? Vendin e dispozitës së re duhet ta përshtatni me krerët e Rregullores që kemi. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet shtimi i një neni të ri me këtë titull dhe këtë përmbajtje.

A ka propozime të tjera?

Klotilda Bushka- Te pjesa e masave disiplinore unë propozoj të shtohen edhe 3 nene të tjera, ose paragrafë, të cilët vijnë si përmbushje e detyrimeve në Kodin e Sjelljes së Deputetëve, ku kemi parashikuar masat përkatëse për shkeljen e rregullave të parandalimit të konfliktit të interesave, rregullat për lobimin në Kuvend dhe rregullat për dhurata apo përfitime të tjera të ligjshme. Unë kam paraqitur 3 propozime për secilën nga këto çështje, ku parashikoj se, nëse shkelen masat për parandalimin e konfliktit të interesave, këto do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit; nëse shkelen rregullat për lobimin në Kuvend, masa do të jetë tërheqje vëmendje dhe detyrimi i deputetit të marrë masë për të korrigjuar situatën e krijuar si pasojë e aktiviteve lobuese të ndaluar dhe në rast përsëritjeje do të zbatohet masa më e rëndë disiplinore. E njëjta gjë është edhe për shkeljen e rregullave për dhuratat dhe përfitimet e tjera të ngjashme. Sugjeroj që te vihen nenet përkatëse të masave disiplinore.

Ulsi Manja- Dy kërkesat e para mund t'i kishit formuluar në një paragraf.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Zoti kryetar, kam një pyetje shumë interesante, të cilën vetëm ti mund ta zgjidhësh. Kemi një Kod Sjelljeje, të cilin e kemi miratuar dhe është i deputetëve, i cili është një libër rregullash që është miratuar dhe duhet ta respektojmë. Edhe Rregullorja është përsëri një libër rregullash për veprimtarinë e deputetëve. Domethënë, kemi dy dokumente, të cilat ne jemi të detyruar t'i respektojmë, sepse mbi bazën e tyre funksionon parlamenti. Ne po marrim një nen nga Kodi i Sjelljes dhe po e fusim në Rregullore, pra, e kemi edhe atje, edhe këtu, duke i dhënë një rëndësi më të madhe Rregullores sesa Kodit të Sjelljes. Ky është shqetësimi parë, që mua nuk më pëlqen.

Së dyti, çfarë do të thotë shprehja “shkelja e rregullave të lobimit në Kuvend”? Unë mund të bëj lobim për një ligj të caktuar, ku mund të marr deputetë dhe t'u them që duhet ta votojmë këtë gjë, t'i bind, jo t'i imponoj dhe, në qoftë se unë ua mbush mendjen dhe bëhemi një grup që do ta votojmë, pse duhet të ma quash shkelje të sjelljes dhe të Rregullores dhe të më hiqet vërejtje, sepse kam lobuar me 15 apo 20 deputetë? Mua më duket jo korrekte që këta tre paragrafë të rifuten përsëri në Rregullore kur ne i kemi në Kodin e Sjelljes. Ndajeni këtë punë ose hajde ta shfuqizojmë Kodin e Sjelljes dhe t'i fusim të gjitha te Rregullorja e Kuvendit, ta mbyllim këtë punë dhe të kemi vetëm një dokument. Ne kemi dhjetëra dokumente, të cilat janë të bashkëngjitura me njëra-tjetrën. A mund të më ktheni një përgjigje për këtë?

Ulsi Manja- Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka- Kodi i Sjelljes është aneks i Rregullores së Kuvendit dhe, si i tillë, është pjesë përbërëse e tij. E kemi parashikuar qartësisht në Kodin e Sjelljes kur e kemi votuar. Edhe ju, kur e keni votuar, keni shkruar që Kodi i Sjelljes është aneks i Rregullores së Kuvendit. Në atë Kod kemi parashikuar se cilat janë rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit, cilat janë rregullat për lobimin në Kuvend dhe cilat janë rregullat për dhuratat. Ne kemi thënë se shkelja e këtyre rregullave do të sanksionohet me masa disiplinore, sipas parashikimeve në Rregullore, sepse nuk do të vëmë masa edhe në Kod, edhe në Rregullore. Sot po zbatojmë ato çfarë kemi parashikuar te Kodi i Sjelljes, ku kemi propozuar këto masa dhe ia kemi lënë pikërisht në Kod Sjellje Rregullores, sepse në Rregullore do të kemi organin përkatës që vendos masat. Kjo është çështja. Sigurisht që do të bëhet lobim në Kuvend, sepse kjo është puna e deputetëve, por do të bëhet sipas rregullave që parashikohen në Kodin e Sjelljes, i cili është pjesë përbërëse dhe integrale e Rregullores.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe dhuratat do të pranohen, por sipas rregullave që ka Kodi i Sjelljes. Edhe konflikti i interesit do të parandalohet sipas rregullave në Kodin e Sjelljes. Pra, ne thjesht po normojmë një set rregullash, për të cilat kemi rënë të gjithë dakord dhe që çdo ditë i kryejmë. Kaq.

Bashkim Fino – Ju thoni...

Klotilda Bushka – Ju e keni votuar.

Bashkim Fino- Sigurisht që e kam votuar, sepse jam i sjellshëm, nuk jam i pasjellshëm dhe më pëlqen Kodi i Sjelljes, duke filluar që nga paraqitja dhe deri në interpretim e të folur. Ti e quan aneks, ndërsa unë e quaj një gjë shumë të rëndësishme Kodin e Sjelljes, por kur themi në rastin e shkeljes së Rregullores për dhurata dhe përfitimet e tjera të ngjashme, kur nuk përbën veprë penale, sepse përndryshe nuk ka nevojë të vijë tek ti apo unë, ndaj deputetit zbatohet masa e tërheqjes së vëmendjes dhe detyrimi i deputetit të marrë masa për të korrigjuar situatën e krijuar, çfarë mase do të marrë deputeti të korrigjojë situatën e krijuar kur i tërhiqet vëmendja dhe në rast përsëritjeje zbatohen masat më të rënda disiplinore? Në masat disiplinore parashikohet një tërheqje vëmendje, vërejtje, që e bën Kryetari i Kuvendit pastaj vazhdon me masat e tjera. Domethënë, po të marr një dhuratë, ai do të më tërheq vëmendjen, do të më bëjë vërejtje, pastaj do të më përjashtojë 10 ditë nga punimet e Kuvendit dhe në fund dhurata ngelet e imja.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për këtë debat!

Në fakt, Kodi i Sjelljes është një legjislacion i butë dhe është pjesë e Rregullores.

Lidhur me konfliktin e interesit, zonja Bushka ka të drejtë kur i referohet ligjit të posaçëm të konfliktit të interesit, sepse kemi një ligj të posaçëm, i cili monitorohet nga organet e Kuvendit, por edhe nga ILDKPI-ja.

Lidhur me dhuratat, në nenin 23 të Kodit të Sjelljes flitet për dhurata dhe përfitime të tjera të ngjashme, ku përcaktohet se çfarë dhuratash nuk lejohet të marrë deputeti dhe çfarë duhet të bëjë deputeti nëse dikush tenton t'i dhurojë një dhuratë, favor apo premtim. Aty përcaktohet se deputeti duhet ta refuzojë, ta marrë, ta regjistrojë e të tjerë. Gjithashtu, Këshilli për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin ka përcaktuar modalitetin dhe ka një regjistër, ku regjistrohen dhuratat, të cilat ekspozohen në mjediset e Kuvendit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, unë nuk flas për dhuratat që marrim ne, sepse ne nuk marrim dhurata, por mund të ndodhë që një drejtues i komisionit mund të marrë një dhuratë nga një homolog i vet, që mund të ketë një vlerë mbi 10 000 lekë të rinj, e cila nuk lejohet të merret dhe për këtë duhet

të depozitohet. Pra, nga vlerësimi që bën Komisioni i Dhuratës del se deputeti duhet ta dorëzojë dhuratën dhe nuk e ka dorëzuar, ai merr masa për ta dorëzuar.

Së dyti, lidhur me lobimin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja -...zoti Qefalia e ka kërkuar fjalën, sepse kjo është pjesë shumë e rëndësishme e Rregullores.

Vasilika Hysi - Më falni!

Kodi i Sjelljes i miratuar në Kuvendin e Shqipërisë është një kod model. Është e vërtetë që ne nuk marrim dhurata të tilla, por duhet të parashikojmë çdo gjë në ligj dhe në kod.

Lidhur me lobimin, nuk ka ligj të veçantë për të, por Rregullorja parashikon si duhet të kontaktojmë me grupet e interesit, me shoqërinë civile. Nuk thuhet se ndalohet, por si rregullohet.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia - Zonja Hysi ishte shumë shteruese, edhe zonja Bushka. Ajo që dua të sjell në vëmendje është meqenëse Kodi i Sjelljes dhe i Etikës që kemi miratuar në parlament është aneks, ndoshta për informacion edhe për publikun: cilat do të jenë rregullat e lobimit që duhet të kemi parasysh?

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi, një sqarim lidhur me rregullat e lobimit.

Vasilika Hysi –Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zoti Qefalia!

Në nenin 21 të Kodit të Sjelljes “Lobimi në Kuvend”, thuhet: “Marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile dhe grupet udhëhiqen nga parimi i integritetit dhe i transparencës. Transparenca e kontakteve me organizatat, grupet” e të tjerë. Pra, ka një manual, ka dhe një shpjegues. Ne kemi në Kuvend një strukturë të posaçme prej disa vjetësh: koordinatorin për shoqërinë civile, i cili merr të gjitha propozimet e organizatave, të grupeve të interesit për amendamente në ligje dhe na i shpërndan ne deputetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë kam kërkuar të ketë në Rregullore rregulla për lobimin. Ne jemi parlamenti i madh, miratojmë shumë ligje dhe është mirë të shmanget konflikti i interesit dhe rregullat e lobimit të jenë të qarta.

Po, zoti Hyseni. Keni propozim konkret?

Alket Hyseni – Po. Po flas për pjesën e dytë, se pjesën e delegacioneve e mbyllëm. Thjesht duhet të shihet përkufizimi që të jetë pak më i saktë. Këto për redaktim ia lëmë edhe grupit të punës, shqipërimet e sakta të termave e të tjera. Të tri këto elemente janë shumë të rëndësishme.

Së pari, erdha pak me vonesë dhe kërkoj ndjesë! Çështja e parandalimit të konfliktit të interesit është shumë sensitive. Jo më larg se para disa ditëve kemi pasur një shkresë nga shoqëria civile për këtë gjë. Prandaj ajo duhet të futet patjetër. Jo në nene më vete te asnjë nga këta, por le të futet te dispozita e përgjithshme e masave disiplinore, pasi konflikti i interesit nuk mund të konsiderohet një masë disiplinore më vete, një shkelje disiplinore më vete, por ka një legjislacion të posaçëm. E fusim te neni i masave disiplinore, duke e referuar te legjislacioni konkret. Kurse 2 të tjerat: shkelja e rregullave të lobimit dhe dhuratat, përfitimet duhet të transpozohen te masat e lehta disiplinore, si një nga rastet për masat e lehta disiplinore. Ne e kemi parashikuar se kur ka përsëritje, kalohet në një shkallë më të rëndë mase. Besoj se gjen zgjidhje konkrete, por pa e prishur strukturën e Rregullores.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka ndonjë merak tjetër për konfliktin e interesit, lobimin dhe dhuratat? Nuk ka.

Atëherë, biem dakord se do të shtohen 3 nene të reja: shkelja e rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi, nëse do i fusni si paragrafë apo si nen të ri më vete. Biem dakord se do të kemi parashikim në Rregullore për konfliktin e interesit, shkeljen e rregullave për lobimin në Kuvend dhe për dhuratat dhe përfitimet e tjera. Jeni dakord të kemi një nen të ri për të tria këto çështje? Kundër? Një kundër. Abstenim? Asnjë abstenim.

Miratohet.

Para se të kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë” është momenti për të bërë disa falënderime, pasi është një draftregullore e punuar prej 2 vjetësh në Kuvendin e Shqipërisë. Janë reflektuar mendimet, sugjerimet dhe komentet e shumë kolegëve që janë përfshirë në diskutimin për ndryshimin e draftregullores dhe janë përfshirë një numër i madh kolegësh, këshilltarët, të pozitës dhe të opozitës, të atyre që ishin dje, por edhe të kolegëve deputetë që janë sot nga opozita.

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj relatore, kolegen Hysi për durimin, për këmbënguljen dhe të gjithë grupin e punës që kanë qenë nën drejtimin e relatores!

Dua të falënderoj stafin e Kuvendit, në mënyrë të veçantë Drejtorinë e Shërbimeve të Seancave Plenare, zonjën Pano, por edhe të gjithë stafin e Kuvendit të Shqipërisë, të gjitha drejtoritë që kanë bashkëpunuar për të dhënë mendime dhe sugjerime konkrete për të reflektuar situatat faktike të punës së përditshme në Kuvend!

Pse jo, një falënderim kam edhe për Komisionin e Ligjeve për zotin Hyseni, zonjën Bushka, për zonjën Xhina, zotin Fino, si edhe për të gjithë kolegët e tjerë që janë përfshirë në ndryshimet e Rregullores.

A ka sugjerime të tjera?

Shumë faleminderit të gjithëve, edhe opozitës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur flas unë më duket se e keni mendjen ende të dhuratat dhe të lobimi. Falënderova të gjithë deputetët e opozitës që ishte dje në sesionin tjetër, se kanë nisur që atëherë ndryshimet e Rregullores, por edhe kolegët e rinj që u përfshinë në këto diskutime.

Faleminderit të gjithëve!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Unë dua t'ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin!

Nuk ka qenë proces i lehtë, por i vështirë, sepse kemi ndërhyrë pas 15 vjetësh në një Rregullore që është shkruar me një gjuhë tjetër, ka pasur një qasje tjetër dhe duhej ta përshatnim me detyrimet e reja që ka Kuvendi i Shqipërisë në kuadër të proceseve të integritetit evropian me detyrat e reja që ka në rritjen e forcimit të kontrollit parlamentar e të tjera.

Mos harroni se ashtu siç e tha me të drejtë edhe zoti Fino, Kuvendi i Shqipërisë është një ndër ata që ka miratuar Kodin e Sjelljes, pasi jo të gjitha parlamentet e kanë një gjë të tillë. Ne na lindën një sërë detyrimesh për të bërë një lidhje edhe të Kodit të Sjelljes dhe Rregullores së Kuvendit.

Bashkohem me falënderimin që kryetari i Komisionit u bëri ish -kolegëve deputetë që kanë punuar në këtë proces. Shumë nga këto dispozita ishin parashikuar të futeshin në Kodin e Sjelljes. Ne i kemi nxjerrë nga Kodi i Sjelljes për t'i vënë në Rregullore. Aktualisht kemi pasur kontribut nga të tria grupet parlamentare.

Me këtë rast më lejoni të falënderoj: zonjën Hajdari, zotin Murrizi, zotin Lita, zotin Përmeti dhe zotin Zeneli që kanë qenë të pranishëm dhe kanë folur, por edhe ata që nuk kanë qenë, kanë dhënë mendimet dhe sugjerimet e tyre për Rregulloren dhe kanë shprehur vullnetin e mirë politik për të pasur një parlament transparent dhe për të forcuar kontrollin parlamentar.

Të ndërruar kolegë, dua të falënderoj në mënyrë të veçantë zotin Fino, i cili ka qenë ndër deputetët e parë që ka paraqitur komente dhe sugjerime, zotin Ervin Bushati, i cili nuk është i pranishëm, Grupin Parlamentar të PS-së, se shumë komente dhe sugjerime kanë ardhur nga grupi parlamentar. Vëmendja e zonjës Xhina bëri që të reflektohej një risi, një qasje e re e parlamentit, por meqenëse këtu nuk e kemi asnjëherë të pranishëm gjithë stafin e Kuvendit, një pjesë e mirë e rekomandimeve dhe sugjerimeve në Rregullore është produkt i punës së çdo drejtorie të Kuvendit të Shqipërisë, përfshirë këtu edhe Gardën e Republikës. Të gjithë kanë dhënë opinionet e tyre, kanë shprehur shqetësimet e tyre, por njëkohësisht kanë riformuluar.

Një falënderim të veçantë, zoti kryetar, e kam për Bashkimin European, për projektin IPA dhe ekspertët e Bashkimit European, për OSBE-në dhe ODIHR-in, pasi ata kanë qenë partnerët tanë kryesorë në hartimin e Kodit të Sjelljes dhe në rekomandimet.

Meqenëse kemi këtu edhe anëtare të Delegacionit Parlamentar në Këshillin e Europës, zonjën Bushka, një falënderim i veçantë i shkon Asamblesë Parlamentare dhe GRECO-s.

Disa nga rekomandimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ia thotë patjetër zonja Bushka, kur të shkojë në delegacion.

Shumica e ndryshimeve në lidhje me transparencën janë bërë me propozim të Bashkimit European dhe të grupit të shteteve antikorrupsion. Të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me transparencën, me punën e deputetëve e të tjera, janë në reflektim. Në këtë mënyrë, Shqipëria përmbush të gjitha rekomandimet që kishte lënë GRECO, që duhej t'i përmbushte brenda korrikut të 2019-ës.

Së fundi, meqenëse kolegu Hyseni dëshiron të marrë fjalën, unë kam një falënderim të veçantë për zotin Hyseni, për zonjën Bushka, si dhe për ju, kryetar! Jo se deputetët e tjerë nuk janë angazhuar, por këta kolegë janë ulur, kanë draftuar, kanë rregulluar, kanë përmirësuar draftin e Rregullores. Nuk ka qenë e lehtë të përshtatej gjuha e vjetër e rregullores së 2004-ës me terminologjinë e me standardet.

Gjithashtu, për ta ditur, por edhe si transparencë për medien, të cilën dua ta falënderoj, në mënyrë të veçantë për mbulimin: medies i është dhënë një hapësirë shumë e madhe në Rregullore. Media dhe gazetarët do të kenë më shumë akses në dokumentacion dhe në të gjitha punimet e Kuvendit. Në shumë nene të Rregullores ka gjetur rregullim të posaçëm aksesit i medies, njoftimi në kohë i medies, vënia në dispozicion e materialeve kohë më parë, jo sot për nesër, ose të na pyesin ne deputetëve. Kjo është meritë e të gjithë stafit të Kuvendit, edhe e zonjës Pano dhe e Aidës, që do të doja t'i falënderoja për gjithë angazhimin dhe kontributin.

Shumë falënderime të gjithë kolegëve të komisionit, për komentet dhe sugjerimet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! Kjo ishte një punë... Besoj se ju do të ma mirëkuptoni gjithë stresin dhe tensionin, pasi na është dashur të negociojmë përmbajtjen e neneve edhe me deputetë, me kolegë, të cilët kanë mendime të ndryshme. Është shumë e vështirë të thuhet se ky është standardi europian, nuk jemi gjithmonë me standardin shqiptar.

Unë do të doja t'ia kaloja fjalën kolegut Hyseni, i cili dje na ka bërë një shërbim shumë të mirë: na ka adresuar një shqetësim në Rregullore, i cili na kishte shpëtuar, që lidhet me shërbimin e sigurisë në Kuvend.

Faleminderit!

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe Sekretariatit të Komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderime për relatore!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – S'ka rëndësi. Profesoreshës ia lejoj këtë gjë. E kam pasur profesoreshë, ndaj ia lejoj këtë gjë.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, në Rregullore ka një nen, i cili ka të bëjë me shërbimet e sigurisë. Është në Rregulloren aktuale, por ka qenë edhe historikisht. Ndërkohë, ka disa akte të Byrosë së Kuvendit, të cilat deri tani kanë rregulluar në mënyrë të detajuar shërbimet e sigurisë. Me një kërkesë edhe nga ana e Shërbimit të Sigurisë, duke qenë se e gjithë ajo punë duhet të transpozohet në Rregullore, pra i gjithë kuadri ligjor që ka qenë deri më tani duhet të transpozohet në Rregullore, në mënyrë të përmbledhur kemi përcjellë ato parashikime të udhëzimeve të byrosë në ndryshimet e nenit 122, nen i cili konsiston në mënyrën se si e kryen veprimtarinë Shërbimi i Sigurisë, duke ia hequr mundësinë të jetë i armatosur në ambientet ku zhvillohen seancat plenare dhe komisionet. Nga ana tjetër, për të qenë eficient në kryerjen e detyrës, i kemi kaluar në Rregullore ato kompetenca që i kanë qenë dhënë me udhëzim të Byrosë, të cilat kanë lidhje me kontrollin për sigurinë e ambienteve parlamentare, në hyrje-daljet e ambienteve. Duhet ta dini se këto janë dispozita që i kanë të gjitha rregulloret e parlamenteve, jo vetëm të Bashkimit Europian, sepse ato i kemi parë, por të të gjithë botës, sepse kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, me sigurinë e kryerjes së aktivitetit parlamentar, me sigurinë e personaliteteve qeveritare, shtetërore, parlamentare, por edhe me çështje të

aktivitetit të përditshëm. Kështu që, është i thjeshtë, është konciz, i është referuar edhe protokollit të shtetit, duke parashikuar rastet përjashtimore, që në ligjin përkatës të protokollit të shtetit janë qoftë për Presidentin e Republikës, qoftë për Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Shtetit.

Kështu që, ju ftoj ta miratojmë! Nuk është ndonjë praktikë e re. Ka qenë dhe është, ne thjesht e kemi vendosur në Rregullore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Lita ka kërkuar fjalën, në lidhje me këtë nen.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, në lidhje me këtë problem, unë kam dashur të flas edhe në seancë plenare, por më duket se e prishi pak atmosferën paqësore kjo që futët tashti në fund, sa i takon miratimit të Rregullores.

Problemi është ky: është e vërtetë se ka pasur disa ngjarje, arsye për të cilën është e nevojshme siguria brenda në Kuvend. Elementët e sigurisë në çdo institucion, por aq më tepër në Kuvend, sigurisht ë janë shumë të rëndësishme, por a ka mundësi që edhe puna të bëhet, edhe të mos krijohet një imazh, që sipas meje është i papranueshëm? Brenda në seancë rrinë forcat e sigurisë! Për ç'arsye rrinë ata në ambientet e seancës? Elementët e sigurisë bëhen dhe kryhen pa u rënë në sy deputetëve. Sigurisht, sigurisht duhet të janë tek dera, në hyrje dalje, por qëndrimi i punonjësve të sigurisë në një rresht me ministrat, qëndrimi te dera e hyrjes në seancës, jo te dera e hyrjes në Kuvend, i pesë bodigardëve, të cilët duhet t'i shtysh me dorë për të hyrë brenda, kjo më duket e pakuptueshme. Na duket vetja sikur jemi në burg. Për më tepër, kur ne po e tregojmë se nuk jemi seancëprishës, nuk jemi të dhunshëm, por jemi shumë paqësorë. Nuk e di pse duhet të jenë brenda në seancë.

Në fakt, këtë çështje kam dashur ta ngre para kryetarit të Kuvendit, që së paku të mos jenë brenda ambienteve ku zhvillohet seanca. Ka plot forma të tjera, që mund të organizohen nga specialistët, që ata të rrinë në mënyrë të padukshme, nëpër vende të caktuara, ku rrinë në gatishmëri dhe sigurisht që ndërhyjnë kur është e nevojshme. Mendoj se brenda mjedisit ku zhvillohet seanca nuk ka pse të ketë punonjës sigurie. Për mua është e papranueshme.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Në fakt, meqenëse unë jam pjesë e Komisionit të Sigurisë, e pashe me shumë vëmendje mënyrën e sjelljes së këtij drafti. Jam plotësisht dakord me mënyrën se si e siguron Shërbimin e Sigurisë në Kuvend. Për hyrjen është në rregull, normale, po për sa i

përket pjesës së fundit, ose më saktë pikës ‘b’, nuk jam dakord, sepse ky është veprim që cenon edhe personalitetin e deputetit. Nuk do të ishte mirë të kishim një përplasje të tillë, që të veprohej me forcë nga punonjësit e gardës. Unë mendoj se është më e udhës ashtu siç është vepruar, të ketë përshkallëzim të masave. Nëse ai nuk bindet, atëherë të kalohet nga masa në masë, deri te masa e fundit, se sa t’i lëmë një hapësirë të tillë Gardës së Republikës për të bërë shoqërimin e tij pa dëshirë. Kjo do të krijonte veç ilaritet, por nuk do të zgjidhte asgjë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Zeneli ka kërkuar fjalën.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen mirë të mos e prishim atmosferën pozitive të miratimit të Rregullores. Edhe për zotin Qefalia, me të cilin jemi anëtarë të Komisionit të Sigurisë, edhe për mua, të gjitha pikat e tjera janë shumë normale, por pika ‘b’ absolutisht jo. Në radhë të parë, ne jemi përfaqësues të popullit, nuk jemi as huliganë e as rrugaçë. Më duket pa sens që, nëse një deputet mund të bëjë një veprim të papëlqyeshëm, që Rregullorja e ndalon, të largohet forcërisht nga salla e Kuvendit. Jam absolutisht dakord që masat të jenë proporcionale. Për mendimin tim, duhet ta heqim absolutisht këtë pikën ‘b’.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Dua t’u bëj një sqarim kolegëve. Së pari, mos e perifrazoni paragrafin me deputetët. Në këtë komision janë rreth 30 karrige për persona të caktuar, ndërkohë vijjnë edhe të ftuar të tjerë për të diskutuar, por edhe grupe interesi, të cilët në raste të caktuara mund të tejkalojnë normat e etikës, pra mund të fyejnë dhe mund të tentojnë të bëjnë akte që janë të parashikuara në këtë Rregullore, që i jep të drejtë drejtuesit të komisionit, sepse mund ta drejtojë edhe nënkryetari, të urdhërojë largimin e personit. Pra, nëse e shikoni, thuhet: “Shoqërimi i personit jashtë kur merret masa për largim”. Por duhet të kemi parasysh që deputetëve të mos u vishni gjëra që i kemi hequr. Deputeti duhet të jetë model në sjelljen e tij.

Kjo pikë nuk është për deputetin, por për të ftuarit, grupet e interesit, përfaqësuesit e institucioneve, për të cilët mund të merren masat përkatëse dhe të shoqërohen jashtë. Termi “jashtë dëshirë” nuk është përdorur për nxjerrjen forcërisht, por për t’i dhënë parlamentit një nivel tjetër solemniteti dhe për të mos e krahasuar me çdo gjë. Këtë e kanë të gjitha parlamentet.

Ju kujtoj një shembull meqë e keni me merak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në Republikën e Shqipërisë dhe nuk jemi në një ishull të rrethuar. Pra jemi deputetë dhe jemi më të mirë se deputetët e Bashkimit Europian, por, nëse bëni gafë të bëni diçka atje, do ta shikoni se si do t'ju marrin shërbimet e sigurisë dhe do t'ju nxjerrin jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Usi Manja – Zoti Hyseni, përmbledheni mendimin, sepse e ka kërkuar fjalën zonja Xhina.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alekt Hyseni – E keni parë në Kosovë, edhe pse është një shtet i ri, policia e UNMIK-ut e kap deputetin nga lecat dhe, e nxjerr jashtë dhe nëse ka kundërshtim të forcave të policisë, ka edhe vepër penale. Pra ajo e bën, ndërsa forcat tona nuk e bëjnë.

Çfarë shqetësimi keni? Ju doni që deputeti të marrë masë dhe të mos e zbatojë, ky është synimi ynë? Çfarë merakuri keni? Nëse deputeti merr masë, atëherë ai duhet të dalë jashtë si qytetar.

Ky nen ka lidhje me personat e tjerë dhe është shumë i rëndësishëm. Mos e merrni përceptas sikur po ruani figurën. Çfarë figure po ruani? Po ruani figurën e një shkelësi ligji? Deputeti duhet të respektojë normat disiplinore dhe ligjin, nëse nuk i respekton, atëherë duhet të mbajë përgjegjësi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni !

Fjalën e ka zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam shumë dakord me nenin e shtuar nga zoti Hyseni, sepse siguron rendin, qetësinë dhe zhvillimin normal të seancës plenare apo të mbledhjeve të komisionit. Me sa kuptoj, neni 122 në tërësi bën fjalë për ruajtjen e sigurisë nga personat e jashtëm, që ndjekin mbledhjet apo seancën plenare dhe jo për deputetët.

Nëse do t'i referohemi nenit 65, i cili bën fjalë për masat disiplinore, përcaktohet shprehimisht se çfarë ndodh nëse deputeti thyen rregullat e normat dhe përjashtohet nga seanca apo mbledhja e komisionit. Për mua kjo është mëse e mjaftueshme dhe nuk duhet të ketë ndryshime.

Për sa i përket shkronjës “b”, është mëse e qartë që flitet për deputetë dhe jo për persona të tjerë, pasi shprehimisht thuhet: “Të jepet masë disiplinore me përjashtim nga seanca plenare apo mbledhja e organeve të Kuvendit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj të rishikojmë qëllimin e shkronjës “b”, nëse duam ta bëjmë për persona të tjerë, atëherë duhet bërë një riformulim dhe ta sjellim në frymën që kërkoni t’i jepni nenit 122.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Kjo nuk ka të bëjë me Rregulloren tonë, por me shërbimin e sigurisë së Kuvendit. Ne e bëmë një rregullore për veprimtarinë tonë. Pra, ky nen tregon se si do të veprojë garda apo punonjësit e tjerë të sigurisë për të zbatuar Rregulloren.

Unë nuk kam vërejtje nëse e vendosim si nen, pavarësisht se denigrohem personalisht, si personalitet që kam gjithë jetën në politikë. Unë denigrohem, sepse kur të futem në parlament do të kontrollohem dhe nuk do të kontrollohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, i cili zgjidhet nga ne, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, madje as ambasadorët.

Po e pranoj këtë denigrim dhe jam dakord, por shkronjën “b” nuk e pranoj dot, sepse thotë: “Shoqërimin e personit jashtë mjediseve të Kuvendit në rastet kur personit i është dhënë masë disiplinore”. Kjo nuk ka të bëjë me atë që tha zoti Hyseni më përpara, pra me gazetarët apo njerëzit e ftuar në një mbledhje komisioni apo në seancë plenare, sepse kryetari për ata nuk merr dot masë disiplinore. Ai mund të thotë: “Nxirre atë gazetar apo person të shoqërisë civile që po prish mbledhjen” dhe garda e nxjerr menjëherë jashtë. Pra këtu bëhet fjalë për masë disiplinore.

Unë mendoj që fjalën e dytë të mos e shkruajmë, sepse nga praktika dhe eksperiencia e gjatë që kam, edhe kur kemi qenë ne, edhe kur kanë qenë ata në opozitë, asnjëherë nuk ka ndodhur nxjerrja me forcë nga garda dhe është bërë mirë. Për shembull, kur Kryetari i Kuvendit ka dhënë masë për Bashkim Finon dhe ai nga inati, në nxehje e sipër, nuk ka lëvizur nga Kuvendi, garda nuk ka pasur mundësi ta nxjerrë me forcë dhe është bërë shumë mirë, seanca është ndërprerë për një ose dy orë dhe ai ka ikur. Me masën e marrë nga Byroja, për shembull për 10 ditë, ai nuk ka të drejtë të futet më. Pra, për shkak të praktikës që kemi pasur, ne nuk kemi përse ta vendosim këtë fjali kot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, unë propozoj që i gjithë neni të ngelet siç është, sepse është deklarativ. Pra po e pranoj të kontrollohem unë dhe të mos kontrollohen ambasadorët, Presidenti dhe të tjerët, por te germa “b” kjo fjali të bëhet kështu: “Shoqërimin e personave jashtë mjediseve të

Kuvendit në rastet kur personi gëzon masë disiplinore me përjashtim nga seanca plenare apo mbledhja e organeve të Kuvendit”. Këtu të mbyllet dhe pjesa tjetër të hiqet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo duhet rregulluar siç thotë zonja Xhina, sepse kjo kuptohet se është për deputetin dhe jo për personin. Pra duhet theksuar, sepse personit nuk ka nevojë t’i marrësh leje, sepse e nxjerr përjashta kur të duash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Hysi, të lutem.

Faleminderit, zoti Fino!

Dua të them edhe unë mendimin tim për këtë nen. Edhe unë jam kundër shkronjës “b”, por jam edhe kundër kësaj forme diskriminimi pozitiv që të mos kontrollohet Presidenti dhe autoritetet e tjera sipas protokollit të shtetit dhe të kontrollohet deputeti. Pra, nuk e pranoj, sepse edhe deputeti është i zgjedhur nga populli dhe gëzon të njëjtin status me të gjitha personalitetet e tjera që rreshtohen këtu.

Neni 122 i Rregullores së Kuvendit e ka zgjidhur deri diku situatën, natyrisht edhe rastet që kemi pasur janë të zgjidhura.

Zoti Hyseni, a e tërhiqni germën “b”?

Alket Hyseni – Dua të kërkoj mirëkuptimin e kolegëve. Garda vepron pa bazë ligjore, nëse një person urdhërohet të nxirret nga drejtuesi i seancës apo mbledhjes, pra nuk ka bazë ligjore për të shoqëruar një të ftuar. Që të mos involvohet deputeti, mund ta riformulojmë duke hequr pjesën: “Nëse është dhënë masa disiplinore e përjashtimit nga seanca”, që lidhet me deputetin, por themi: “personat...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, sepse është me akt të Byrosë.

Ulsi Manja – A ka një propozim konkret?

Alket Hyseni – Po, mund ta bëjmë: “Shoqërimin e personit jashtë ambienteve të Kuvendit kur kërkohet nga drejtuesi i mbledhjes”, pra nuk lidhet me deputetin. Deputeti ka një rregullim të posaçëm te masa disiplinore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... që t’i japim legjitimitet gardës, sepse mund të vihet në pozitë; ai person mund ta padisë nesër, duke thënë: “më kanë prekur me dorë pa një akt”.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Zeneli, ju lutem!

Zoti Hyseni, garda nuk ka nevojë për autorizimin tonë që të nxjerrë nga seanca personat që nuk kanë lidhje me deputetët.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, ka propozime konkrete nga deputetët?

Person – Propozimi konkret është që germa “b” është e papranueshme dhe duhet të hiqet.

Ulsi Manja – Ju lutem, ka propozim...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Pra, bie propozimi për nenin 122!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por çfarë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Atëherë, ka një ndryshim në nenin 122, sipas propozimit që ka sjellë kolegu Hyseni, të cilin e keni para, si dhe një propozim të opozitës për t’u hequr germa “b”.

Vasilika Hysi – Por ngelet ajo që është.

Ulsi Manja – Po, sigurisht që do të ngelet ajo që është.

Atëherë, nëse zoti Hyseni nuk tërhiqet nga germa “b”, do të hedhim në votim propozimin e zotit Zeneli.

(Diskutime pa mikrofon)

Alket Hyseni – Ka dy propozime: propozimi i nenit me korrigjimet që bëra unë, që sapo i thashë, dhe një propozim të nenit, duke e hequr të gjithë pikën.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Do të hedhim në votim propozimin e kolegëve të opozitës, si propozimi më i largët.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Përmeti, mund ta hedhim në votim?

Nëse nuk jeni dakord me propozuesin për germën “b”, ka një propozim konkret nga tri kolegët e opozitës për ta hequr germën “b”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Atëherë, do të hedhim në votim propozimin e kolegut Hyseni për riformulimin e nenit 122, pa germën “b”, si propozimi më i largët i kolegëve të opozitës.

Kush është dakord të kemi riformulimin e nenit 122, që propozon kolegu Hyseni, pa germën “b” në pikën 4 të këtij propozimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, ju lutem, t’i numërojmë!

9 vota.

Atëherë, pranohet propozimi i kolegëve të opozitës, që të pranojmë propozimin e kolegut Hyseni për riformulimin e nenit 122, pa germën “b” në pikën 4.

Hedhim në votim nenin 122, sipas variantit të propozuar nga kolegu Hyseni, pa germën “b”.

Kush është pro? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 122 “Shërbimi i sigurisë në Kuvend”, pa germën “b” në nenin 4.

(Diskutime pa mikrofon)

Kolegë, ju lutem!

Para se ta votojmë në tërësi, relatores dhe stafit të Kuvendit, në përfundim, do t’ju lutesha të kemi një draft të zbardhur, të numërtuar sipas neneve të reja që kemi shtuar, pra të kemi një draft të integruar për ta votuar në seancë plenare.

Kush është dakord në tërësi me projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen me konsensus të plotë ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.

Raporti, drafti i zbardhur, i numërtuar sipas neneve të reja që janë shtuar, teksti integral, ditën e enjte do të kalojnë për votim në seancë plenare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.07.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil, për vitin 2018”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Korab Lita, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Edmond Leka Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Andi Përmeti, Elda Hoti, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Spartak Braho, Aurora Mara, Damian Gjikhuri, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil, për vitin 2018”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino. Tekstin e projektrezolutës e keni në tavolinë.

Zoti Fino, jemi dakord me tekstin e projektrezolutës?

Bashkim Fino – Projektrezoluta është bërë në funksion të të gjithë debatit dhe diskutimit që bëmë para disa ditësh në këtë komision, kur ishin të ftuar Zëvendëskryeministri dhe drejtoresha e DAP-it.

Unë nuk po zgjatem në pjesën e parë të projektrezolutës, por po flas për pjesën e fundit, ku ne si Kuvend kemi të drejtë t’i vendosim detyra DAP-it.

Ndër detyrat që kemi vendosur janë të gjitha problematikat, pyetjet dhe sugjerimet që bënë kolegët deputetë kur diskutuam. Si Kuvend, do t’i kërkojmë DAP-it të intensifikojmë monitorimin, së bashku me Komisionerin e Mbrojtjes së Shërbimit Civil dhe me institucionet e tjera për mënyrën e sjelljes së nëpunësve gjatë fushatës zgjedhore, si dhe të identifikojë dhe të marrë masa për nëpunësit civilë që veprojnë në kundërshtim me ligjin. E kemi vënë si pikë kryesore, që të na japë sqarim vitin tjetër.

Së dyti, të kryejë një vlerësim të menjëhershëm për ndërhyrjen e nevojshme në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, me qëllim zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky ishte një nga diskutimet që ne kemi bërë dhe e kemi vënë si kërkesë kryesore.

Së treti, është një nga kërkesat që unë kam bërë edhe si relator, për të zhvilluar një politikë gjithëpërfshirëse për një skemë pagash të drejtë, transparente, të bazuar në meritën e zbatueshme të institucioneve, por me korrigjimin e fjalëve “edhe nëse vlerësohet”. Pra, të hiqen fjalët “edhe nëse” dhe të thuhet “të vlerësohet i arsyeshëm propozimi i ndryshimit të kuadrit ligjor”; të mos themi “nëse e shikon të arsyeshme”, por ta heqim këtë dhe të themi “të vlerësohet e arsyeshme”.

Tjetra, kemi vënë një pikë ku thuhet: “DAP-i duhet të krijojë mekanizmin e ndërgjegjësimit, informimit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së kandidatëve me nivel të lartë kualifikimi në procesin e rregullt të rekrutimit dhe të publikimit të shpalljes jo vetëm në portalin *online* në qarkullim, por edhe të zgjerojë kanalet e informimit të publikut”.

Kemi vendosur një pikë tjetër, ku thuhet: “të fillojë menjëherë rishikimin e strukturave funksionale të institucioneve me vëmendje në fokusin e njësive të ministrive”.

Tjetra: “DAP-i duhet të përmirësojë cilësitë e përshkrimit të punës dhe të shikojë metodologjinë e klasifikimit të pozicioneve të punës”.

E fundit: “DAP-i duhet të harmonizojë dhe të unifikojë procedurat për lëvizjen në tërësi të sistemit të shërbimit civil nëpërmjet krijimit të një portali të aksesueshëm nga të gjitha institucionet e administratës publike”.

Këto janë pikat kryesore që ne kemi diskutuar; kemi bërë pyetje dhe sugjerime konkrete dhe do t’ua lëmë detyrë Zëvendëskryeministrit dhe drejtorisë së DAP-it për t’i zbatuar vitin tjetër.

Ndërkohë, sipas propozimit tuaj, zoti kryetar, kemi vënë edhe dy-tri rekomandime për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për vitin 2019, që të angazhohet në dy çështje kryesore:

të ndërmarrë hapa të nevojshëm për realizimin e procesit të vlerësimit të nevojës për trajnim dhe për këtë qëllim të përcaktojë njësitë e brendshme përgjegjëse;

së dyti, të përditësojë vazhdimisht dhe në kohë reale *database*-n me të dhënat e nëpunësve të trajnuar, duke hartuar dhe miratuar objektivat e kënaqësisë së klientit për kurse trajnimi të kryera, për vlerësime periodike të cilësisë së trajnimeve të ofruara sipas kërkesës së strategjisë ndërsektoriale dhe të reformës në administratën publike gjatë viteve 2015-2020.

Këto janë në përgjithësi pikat që Kuvendi ka vendosur për Zëvendëskryeministrin dhe DAP-in në kuadrin e diskutimeve dhe pyetjeve që kemi bërë këtu para disa ditësh.

Nëse kolegët kanë ndonjë pikë tjetër, mund ta shtojmë te kërkesat që kemi për të miratuar dhe për t’i votuar në seancë plenare ditën e enjte.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Keni ndonjë gjë për të shtuar për projektrezolutën? Nuk keni.

Unë jam shumë dakord me projektrezolutën dhe me ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – E falënderoj relatorin për rezolutën, sepse është shumë e përpiktë dhe e bazuar në diskutimet që janë bërë, por ndryshe nga të gjitha herët e tjera, që zoti Fino propozon afate, nuk i ka vendosur.

Bashkim Fino – Nuk i kam vendosur, sepse kam besim te Zëvendëskryeministri.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Kush është dakord me tekstin e projektrezolutës, sipas variantit që keni në tryezë dhe me sugjerimet e zotit Fino? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil, për vitin 2018”.

Kjo projektrezolutë, bashkë me raportin përkatës, të bëhen gati për seancën plenare të datës 18 korrik.

Faleminderit!

E mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Fundjavë të mbarë!

Faleminderit për korrektësinë!

MBYLLET MBLEDHJA